



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsimit dhe Edukimit

Nr. 11/

Më: / /2021

18-08-2021
11/1697

Në bazë të nenit 68 paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë e në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212,(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës e. të Ligjit për Arsimin në Komuna e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-032, të datës 29.08.2011 nenit 34 dhe 35 Udhëzimit Administrativ (MPMS)Nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4, Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

KONKURS

Viti shkollor -2021/2022

Nr.	Niveli, Shkollat	Pozita	Vendi i hire/zëvendësimit	Numri i pozitave	Ore
1	SHFMU" Xhevd Krasniqi-Lladroci" në Drenoc, me 16 orë mësimi në javë dhe në SHFMU" Dëshmoret e Fshatit Bubavec" në Bubavec me 4 orë mësimi	Matematikë	Zëvendësim i lehonisë	1	20
2	SHFMU" Xhevd Krasniqi-Lladroci" në Drenoc	Mësim klasorë	Zëvendësim i lehonisë	1	20
3	SHFMU" Vesel Pagarusha" në Pagarushë	Mësim klasorë	Zëvendësim me kohë të caktuar	1	20
4	SHFMU" Gjergj Kastrioti" në Lluzicë	Mësim klasorë	Zëvendësim me kohë të caktuar	1	20
5	SHFMU" Ismail Qemali" në Bellanicë me dymbëdhjetë (12) orë TIK dhe në SHFMU" Ismet Jashari-Kumanova" në Temiqinë me tetë (8) orë mësimi në javë	TIK	Zëvendësim me kohë të caktuar	1	20
6	SHFMU" 18 Prilli" në Burim	Mësim klasorë	Zëvendësim me kohë të caktuar	1	20
7	SHFMU" Habib Berisha" në Gurbardh	Histori	Zëvendësim me kohë të caktuar	1	8

Kandidatët konkurojnë në shkollat e lartëcekura në listën pritëse dhe shpallën fitues, fillojnë punë me rastin e shkurjes në pushim të lehonisë apo zëvendësimit të punëtorve me smundje kronike. Lista pritëse vlenë për vitin shkollor 2021-2022.

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulart i aplikimit
- Rezumeja personale (CV)
- Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore (nëse ka)

- Çertifikata e lindjes

II. Kushtet dhe Kualifikimi:

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të përgjithshëm.

Në mungesë të kandidatëve me kualifikim përkatës, do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente(jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)

Për intervistë do të ftohën ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në ueb- faqen e Komunës së Malishevës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Kandidatët fitues sipas pikës (1) një dhe pikës dy (2) të konkursit, fillojnë punën me rastin e shkuarjes së punëtorjes në pushim të lehonisë.

Themelimi i marrëdhënies së punës:

Marrëdhënia e punës themelohet vetëm nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim me Qytetar në Komunën e Malishevës. Data e njoftimit në web faqen: <https://kk.rks-gov.net/malisheve/category/shpalljet/>, <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>, është prej dt; 17.08.2021 deri me dt, 16.09.2021, ndërsa data e aplikimit është nga dt; 17.09.2021 deri me dt; 01.10.2021, në intervistë do të ftohën vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

Të gjithë kandidatët që kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kushte të konkursit.

Në intervistë do të ftohën vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

Rezultatet shpallën në linkun: <https://kk.rks-gov.net/malisheve/category/shpalljet/konkurset/>